



Republika e Kosovës

| | |
|--|--------------|
| REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO | |
| KOMUNA E VUSHTRRIË - OPŠTINA VUČITRN | |
| 01 Nr. / Nr. | 91/20 |
| Nr. i fq. / Nr. sht. | - 1 - |
| Data / Datum | 28. 05. 2020 |
| VUSHTRRI - VUČITRN | |



Kuvendi i Komunës-Vushtri

Bazuar në nenin 12, pika 12.2, shkronja “d” të Ligjit nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 5 paragrafi 1 pika 1.1 dhe nenin 8 paragrafi 1 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 01/2016 për Procedurën e Themelimit, Organizimin dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna, nenit 41 paragrafi 41.2 shkronja “ç” të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 28 maj 2020 merr këtë:

VENDIM
PËR SHPALLJEN E KONKURSIT PËR ZGJEDHJE TË ANËTARËVE TË
KOMITETEVE KONSULTATIVE

1. Miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës për shpallje të konkursit për zgjedhje të anëtarëve të komiteteve konsultative të Kuvendit si në vijim:

- 1.1.Komiteti Konsultativ për Arsim, Kulturë, Fe, Sport dhe Rini (7 anëtarë);
- 1.2.Komiteti Konsultativ për Zhvillim Ekonomik dhe Shërbime Publike (7 anëtarë);
- 1.3.Komiteti Konsultativ për Urbanizëm dhe Mbrojtjen e Ambientit (7 anëtarë);
- 1.4.Komiteti Konsultativ për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale (7 anëtarë);
- 1.5.Komiteti Konsultativ për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore (7 anëtarë);

2. Kushtet dhe kriteret e konkursit duhet të jenë në përputhshmëri me nenin 8 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 01/2016 për Procedurën e Themelimit, Organizimin dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna.

3. Kompensimi i anëtarëve të komitetit bëhet në pajtim me nenin 14 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 01/2016 për Procedurën e Themelimit, Organizimin dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna.


4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Kryesuesi i kuvendit, Njësia e Personelit dhe Sekretaria e kuvendit.

5. Ky Vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.



Nasuf Aliu

Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2 pika "d" të Ligjit Nr.03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 41, paragrafi 2 pika "ç" të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 28 maj 2020, mori këtë:

VENDIM
PËR APROVIMIN E PLANIT ZHVILLIMOR INSTITUCIONAL I KUJDESIT
PARËSOR SHËNDETËSOR 2020-2024

1. Me këtë vendim aprohet Plani Zhvillimor Institucional i Kujdesit Parësor Shëndetësor 2020-2024.
2. Qëllimi i aprovimit të këtij plani është konsolidimi i infrastrukturës juridike me qëllim të arritjes së objektivave në drejtimin e qartë të politikave të kujdesit shëndetësor në komunë, i cili do të jetë udhërrëfyes i vlefshëm për planifikimin e aktiviteteve në Kujdesin Parësor Shëndetësor.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare dhe sektorë tjerë kompetent që i referohen këtij dokumenti.
4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është dokumenti me emërtimin Plani Zhvillimor Institucional i Kujdesit Parësor Shëndetësor 2020-2024 i Komunës së Vushtrrisë.
5. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Nasuf Aliu



Kryesues i Kuvendit